



**Bordi
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

VENDIM

Nr. 189, Datë 23.11.2017

MBI

**MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMEVE PËR
SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE ME PAKICË TEK KLIENTËT QË
FURNIZOHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19 gërma "b"; të ligjit nr. 43/2015 "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*"; neni 6 i VKM nr. 244 dt. 30.03.2016, "*Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike*", nenit 26 të "*Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE*", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016"; Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 23.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, mbi miratimin e "draft – Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal",

Konstatoi se:

- Me Vendimin Nr. 182 dt. 23.11.2016, Bordi i ERE-s vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal.
- Vendimi u dërgua për publikim në shtypin e shkruar nëpërmjet shkresës nr. 26/44 prot, datë 09.12.2016 të ERE, për të marrë opinionin e palëve të interesit.
- ERE ka njoftuar të gjitha palët e interesuara (OSHEE sh.a; MEI; Autoriteti i Konkurrencës; Avokati i Popullit; Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorit Shqiptar; Shoqata e Konsumatorit Shqiptar; Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë; Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë; Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë dhe Konfindustria)
- U paraqitën komente nga Electricity Trading Origination Manager for Albania and Kosovo.
- ERE organizoi një seancë dëgjimore me përfaqësues të ERE dhe OSHEE sh.a. gjatë se cilës nuk u konstatuan të meta në draft.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë “Metodologjinë e përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal.” (Bashkëlidhur)
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit AHMETI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

Votimi i Bordit të ERE, për

VENDIMIN

Nr. 189, Datë 23.11.2017

MBI

**MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMEVE PËR
SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE ME PAKICË TEK KLIENTËT QË
FURNIZOHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL.**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____